



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-017
Prishtinë, më 17 qershor 2020, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 QERSHOR 2020

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit; Arbërie Nagavci, Kujtim Shala dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga grupet parlamentare: Rexhep Selimi, Arben Gashi, Bedri Hamza, Teuta Haxhiu dhe Haxhi Shala.

Nga Kabineti i kryetares: Faton Peci dhe Artan Murati.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Musli Krasniqi dhe Shefki Shoshaj.

Nga KDI-ja: Agnesa Haxhiu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

* * *

Në fillim të mbledhjes, kryetarja i njoftoi të pranishmit me raportin e Komisionit Funkcional për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, për të cilin duhet të vendosë nëse do të përfshihet në rendin e ditës për seancën plenare të radhës.

Kryetarja theksoi se në lidhje me raportin e lartshënuar, nga një grup i deputetëve nëpërmjet një shkrese, është kontestuar procedura e propozimit të kandidatëve në aspektin e përfaqësimit gjinor sipas detyrimeve ligjore për përfaqësim të barabartë gjinor në borde.

Në lidhje me raportin e Komisionit Funkcional për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it diskutuan: kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu; Fikrim Damka e Arbërie Nagavci, nënkryetarë të Kuvendit, dhe Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së dhe Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me rekomandimin e Komisionit Funkcional për zgjedhjen e Bordit të Drejtorëve të NP KOSTT, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni Funkcional për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike që ta rishqyrtojë raportin me rekomandime për zgjedhjen e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT, për respektimin e detyrimit ligjor për përfaqësimin të barabartë gjinor në borde të shoqërive aksionare, si dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Pastaj, kryetarja procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin mbledhjes së mbajtura më 8 qershor 2020.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi, të martën, më 23 qershor 2020, t'i mbajë dy seanca plenare, si në vijim.

I. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e filluar më 11 qershor 2020, do të mbahet të martën, më 23 qershor 2020, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar,*
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan,*
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin e Projektit për Kadastër të Patundshmërisë dhe Infrastrukturë Gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,*
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit “Dogana 2020”,*
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit “Fiskalis 2020”.*

II. Seanca e re plenare të mbahet të martën, më 23 qershor 2020, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 2. Pyetjet parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*

4. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre (3) anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media,*
5. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për shtatë (7) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
6. *Propozimi i GP Nisma Socialdemokrate për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare,*
7. *Interpelancë me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti,*
8. *Raportim i kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe debat parlamentar lidhur me dialogun Kosovë - Serbi.*

Kryesia, gjithashtu, në lidhje me pikat 4 dhe 5 të lartshënuara nxori edhe këto përfundime:

I. P Ë R F U N D I M

1. Kërkohe nga grupet parlamentare të Kuvendit që para se të mbahet seanca plenare më 23 qershor 2020 t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy (2) kandidatëve nga radhët e komunitetit shqiptar dhe një (1) kandidati nga komunitetet tjera joshumicë.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së 3 anëtarë (kryetarin dhe 2 anëtarë); GP i LDK-së, 2 anëtarë (nënkryetarin e parë dhe 1 anëtar); GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i Listës serbe, 1 anëtar (nënkryetarin e dytë); GP i Nismës Socialdemokrate, 1 anëtar, dhe GP 6+, 1 anëtar.

II. P Ë R F U N D I M

1. Kërkohe nga grupet parlamentare të Kuvendit që para se të mbahet seanca plenare më 23. 6. 2020 t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për shtatë (7) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre: pesë (5) nga komuniteti shumicë shqiptar, një (1) nga komuniteti serb dhe një (1) nga komunitetet tjera joshumicë.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së, 3 anëtarë (nënkryetarin e parë dhe 2 anëtarë); GP i LDK-së, 2 anëtarë (kryetarin dhe 1 anëtar); GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i Listës serbe, 1 anëtar; GP i Nismës Socialdemokrate, 1 anëtar, dhe GP 6+, nënkryetarin e dytë.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

3.1 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Transfere lidhur me rishikimin e Buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2020

Kryesia, pasi e shqyrtoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Transfere, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet rishikimi i Buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2020, i përgatitur nga Komisioni për Buxhet dhe Transfere, në bashkëpunim me Administratën e Kuvendit.

2. Ministria e Financave të njëjtat ndryshime dhe plotësime, sipas dokumentit të bashkangjitur, t'i përfshijë në linjat buxhetore në rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020.

3.2 Njoftimi i Komisionit për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike në lidhje me kërkesën e KOSTT-it për miratimin e Planit të biznesit të rishikuar dhe të buxhetit të rishikuar për vitin 2020

Kryetarja, në lidhje me njoftimin e lartshënuar, theksoi se do të pritët funksionalizimi i Bordit të KOSTT-it, pasi është në procedurë zgjedhja e anëtarëve të këtij bordi, të cilët pastaj do ta miratojnë vetë Planin e biznesit të rishikuar dhe të buxhetit të rishikuar për vitin 2020.

3.3 Kërkesa e deputetes Ariana Musliu-Shoshi për lejimin e shfrytëzimit të një (1) zyre në Kuvendin e Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Në mungesë të hapësirave të mjaftueshme në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, aktualisht zyrë sigurohet për nënkryetarët e Kuvendit, për kryetarët e grupeve parlamentare dhe për kryetarët e komisioneve parlamentare, ndërsa për deputetët pritët të sigurohen zyra pas lirimimit të ndërtesës së Kuvendit nga Presidenca.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, të bisedojë me Sekretarin e Zyrës së Presidentit në lidhje me planet e Presidencës për lirimimin e hapësirave të ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3.4 Caktimi i hapësirës për vendosjen e “Këndit të Kurajës”

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me caktimin e hapësirës për vendosjen e “Këndit të Kurajës”, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Ismet Krasniqi, që në konsultim me deputeten Donika Kadaj-Bujupi, si iniciuese e Rezolutës për krijimin e “Këndit të Kurajës”, ta përgatisin listën e organizatave që përfaqësojnë dhe promovojnë punimet artizanale të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së vitit 1999 dhe Kryesisë së Kuvendit t’ia propozojë konceptin dhe mënyrën e ekspozimit të tyre në hapësirat e ndërtesës së Kuvendin e Kosovës.

3.5 Propozimi për vendosjen e pllakës përkujtimore për 1 133 fëmijë të vrarë në luftë në ulësen për deputet në mes të sallës

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e kryetares së Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, për vendosjen e pllakës përkujtimore për 1 133 fëmijë të vrarë në luftë në ulësen për deputetë në mes të sallës, mori këtë:

V E N D I M

1. Kryesia e miratoi propozimin që një ulëse e deputetëve në mes të sallës të mbetet e zbrazët në shenjë përkujtimi për 1 133 fëmijët e vrarë në luftë dhe të vendoset pllaka përkujtimore.
2. Pllaka përkujtimore për 1 133 fëmijë të vrarë në luftë do të dizajnohet dhe vendoset pas konsultimeve me përfaqësuesit e familjeve të fëmijëve të vrarë gjatë luftës, me komunitetin artistik, me profesionistët e tjerë dhe me shoqërinë civile.

3.6 Programi Legjislativ i Qeverisë së Kosovës për vitin 2020

Kryesia, pasi diskutoi për Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2020, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Programi Legjislativ i Qeverisë së Kosovës për vitin 2020 t’u shpërndahet deputetëve të Kuvendit dhe komisioneve parlamentare.

4. Të ndryshme

4.1 Njoftim me Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 05/05, datë 15. 6. 2020

Kryetarja i njoftoi të pranishmit me Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 05/05, datë 15. 6. 2020, me të cilin Qeveria është deklaruar edhe për disa materiale të proceduara në Kuvend nga Qeveria në dorëheqje.

Me vendimin e lartshënuar, Qeveria është deklaruar që **të procedohen për shqyrtim** në Kuvend:

- Raporti i Statistikave Zyrtare për vitin 2019,
- Raporti tremujor financiar për vitin 2020.

Ndërsa, Qeveria i **ka tërhequr nga proceduat** e Kuvendit:

- Projektligjin ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 04/L-123 të procedurës penale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-091,
- Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024.

4.2 Njoftim me propozimet e deputetëve për anëtarë për formimin e delegacioneve të përhershme në organizata ndërkombëtare, në grupe të miqësisë dhe në grupet joformale të deputetëve

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se edhe pas kërkesës së fundit të Kryesisë së Kuvendit, disa grupe parlamentare ende nuk i kanë proceduar propozimet e tyre për delegacione, grupe të miqësisë dhe grupe joformale të deputetëve.

Ajo kërkoi sërish nga grupet parlamentare që nëpërmjet Administratës së Kuvendit t'i propozojnë sa më parë deputetët nëpër delegacionet dhe grupet e lartshënuara. Diskutimi i plotë i kryetares është i dhënë në transkript.

4.3 Deputetja Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së i shtroi dy çështje:

- a) Kontratën e punës për asistenten e Grupit joformal të Grave Deputete, dhe
- b) Zgjedhjen e Avokatit të Popullit, pasi Avokatit të Popullit i përfundon mandati më 2 korrik 2020.

4.4 Kërkesa e nënkryetares Arbërie Nagavci për seancë të jashtëzakonshme

Nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, propozoi që Kryesia e Kuvendit të vendosë mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme të Kuvendit për ta ftuar kryeministrin e Republikës së Kosovës që të raportojë para takimit që do ta ketë më 27 qershor 2020 në

Uashington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në lidhje me vazhdimin e dialogut me Serbinë.

Në lidhje me propozimin e lartshënuar të nënkryetares së Kuvendit, znj. Nagavci, diskutuan: nënkryetarët e Kuvendit: Kujtim Shala e Arbërie Nagavci, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu, si dhe Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, vendosi që kryetarja e Kuvendit, znj. Osmani-Sadriu, t'i drejtohet me një letër kryeministrit të Republikës së Kosove, z. Avdullah Hoti, për gatishmërinë e tij për të raportuar në Kuvend në lidhje me vazhdimin e dialogut me Serbinë, që do të mbahet takimi më 27 qershor 2020, në Uashington të Shteteve të Bashkuar të Amerikës.

Kryetarja e Kuvendit e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:45 minuta.

Vjosa Osmani - SADRIU

Kryetare e Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale